



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë:

KONKURS

1. Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Bibliotekist

Numri i referencës : ASK-DMTI-se -002

Koeficienti : 6

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Bën shërbimin dhe pasurimin librarë të bibliotekës së ASK-së.
- Klasifikimin decimal librarë.
- Katalogimin librarë.
- Vërjen në shërbim të publikimeve lexuesve dhe hulumtuesve pjesëmarrës në bibliotekë.
- Furnizimin e bibliotekës me material publicitar të kërkuar.
- Raporton në baza ditore, javore dhe sipas nevojës edhe për afate më të gjata për dinamikën e kryerjes së punëve;
- Kryen edhe punë tjera varësisht prej kërkesave të Udhëheqësit divizionit.

Kualifikimi : Diploma universitare, Fakulteti nga fushat ekonomike, shoqërore, apo të ngjashme

Përvoja e punës: Së paku 4 vite përvojë pune në fushën relevante

Kompetenca dhe aftësitë: Njohja e kompjuterit (Word ,Excel, Outlook) ,

-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,

-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit ,

-Aftësi të njohjes së Gjuhës Angleze

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi

mbi përvojën e punës , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.